



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.764/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Taulant Pallqa votues në Komunën e Rahovecit, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** si i pabazuar apeli i parashtruar Taulant Pallqa votues në Komunën e Rahovecit, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 15:55, ka pranuar një apel nga Taulant Pallqa votues në Komunën e Rahovecit, në të cilin pretendon se në vendvotimin 1601A/04R e ka votuar kandidatin për Kuvendin Komunal, Ilir Pallqën me nr. 17 të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa nga rezultatet rezulton se në këtë vendvotim ai kandidat ka 0 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së apelit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, duke u bazuar ne nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ne apel të apeluesit gjeti se, apeluesi nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të dëshmuar pretendimet e tij për parregullsi. Prandaj Paneli apelin e apeluesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla apeli i ankuesit u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë duke u bazuar në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**  
ZL.Anr.764/2017 me datën 12.11.2017.



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.